



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS  
ZYRA VENDORE ARSIMORE VORE

Nr. 841/3 Prot.

Vore, më 15.11. 2023

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Zyra Vendore Arsimore Vore, në zbatim të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.7961 dt.12.07.1995“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore”, Udhëzimi Nr.3, datë 9.02.2022, “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”. Udhëzimit Nr 14 datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe të shkresës nr.495prot., datë 14.11.2023, të shkollës gjimnazi Isa Adem Boletini, shpall konkursin për vendin e lirë në pozicionin Nëndrejtor i Institucionit Arsimor Publik në:

**1. SHKOLLËN E ARSIMIT GJIMNAZI ISA ADEM BOLETINI VORE**

***Kriteret për nëndrejtorin e institucionit arsimor publik***

Kriteret për nëndrejtorin e institucionit arsimor publik janë:

- Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”, me vlerësimin jo më pak se “Mirë”, në kualifikimin e fundit.
- Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.
- Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.

***DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT***

- a) Jetëshkrimi (CV) dhe kopjet e njehësuar me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur Udhëzimit nr. 3, datë 09.02.2022).
- b) Kopjen e njehësuar me origjinalin të librezës të punës.
- c) Kopjen e dokumentit të identifikimit (ID).
- d) Tabelën me të dhënat për aplikantin (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 4, bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 3, datë 09.02.2022).
- e) Certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorave që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.
- f) Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, bashkëlidhur Udhëzimit nr. 3, datë 09.02.2022).
- g) Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- h) Deklaratën e konfliktit të interes me punonjësit arsimor të IPAP (bashkëshort/ bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/ bashkëshortes), (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3, bashkëlidhur Udhëzimit nr. 3, datë 09.02.2022).

Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij I vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumentave të mëposhtëm:

- a) *Planin afatmeësm të shkollës;*
- b) *Planin vejtör të shkollës të vitit paraardhës;*
- c) *Planin vejtör të shkollës të vitit pasardhës;*

- Dorëzimi i dokumentacionit të aplikantit do të bëhet nëpërmjet **shërbimit postar** në adresë të shkollës gjimnazi Isa Adem Boletini Vore, me adresë **Rruga Rinia nd.161**.
- Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët do të jetë jo më vonë se afatet ligjore të përcaktuara në ndarjen C, Kreu 1, të Udhëzimit Nr. 3, datë 09.02.2022.
- Afati i plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak (nëse do ketë mangësi të konstatuara) do të jetë brenda 3 (tre) ditëve punë nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.
- Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të sakët dp të kryejnë intervistën e strukturuar për fushat e njohurive dhe aftësitë mbi:

- \* Ligji 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
  - \* Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - \* Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit parauniversitar 2021-2026.
  - \* Udhëzimi Nr.3, datë 9.02.2022, “Për procedurat e emërimit, uljes ne detyre, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit public të arsimit parauniversitar”.
  - \* Udhëzimi I të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" i ndryshuar,
  - \* Udhëzimi Nr 30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar, i ndryshuar.
  - \* Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, indryshuar.
  - \* Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e profesioneve publike”.
  - \* Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë.
  - \* Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.
  - \* Udhëzuesi “Vlerësim i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës”, ASCAP, 2019.
  - \* Udhëzimet për zhvillimin e kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët (AMU).
  - \* Udhëzuesin kurrikular lëndor në arsimin e mesëm të ulët (material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin e mesëm të ulët sipas profileve përkatëse, ASCAP 2018) në zbatimin e kurrikulës së re.
- Rezultatet e konkurrimit do të publikohen në këndin e njoftimeve të shkollës gjimnazi Isa Adem Boletini Vore, sipas afateve të përcaktuara në pikën 10, ndarja C, Kreu 1, të Udhëzimit Nr.3, datë 09.02.2022.
  - Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para komisionit brenda 3 (tre) ditëve.
  - Procedurat e mëtejshme vazhdojnë sipas përcaktimeve të Kreut I, të Udhëzimit Nr.3, datë 09.02.2022.